



Teqeja e Dollmës

Teqeja e Dollmës është shpallur Monument Kulture i Kategorisë së parë (I) për vlerat e saj arkitekturore, dekorative dhe tipologjike, datë 10.06.1973.

Ajo është një pikë referimi e rëndësishme për komunitetin lokal të qytetit historik të Krujës, si dhe një pasuri e rëndësishme për komunitetin fetar bektashi në zonë. Në gjininë e faltoreve islamike ajo përfshihet në tipin e vogël monumental me kupolë.

Faltorja është një konstruksion me një vëllim me bazë katrore. Mbi katër faqe muri të gurtë, nëpërmjet tropmave kalohet në tamburin oktogonal, mbi të cilën ngrihet kupola gjysmësferike e mbuluar me tjegulla vendi.

- Tërmeti i nëntorit 2019, preku edhe Teqenë e Dollmës, duke dëmtuar muret dhe kupolën e saj.
- Në vitin 2020 u kryen punime emergjente konsolidimi për të reduktuar në afat të shkurtër rrezikun e kolapsit total.
- Në vitin 2021, CHwB Albania nisi zbatimin e projektit për konservimin dhe restaurimin e këtij objekti.
- Në Qershor 2024 kanë rinisur punimet për restaurimin e kësaj pasurie kulturore pas një pezullimi pothuajse një vjeçar të punimeve.









